



Ministria e Brendshme  
Koordinatori Kombëtar kundër  
Trafikimit në Njëz



100 Vjet Shtet Shqiptar

# Punonjësit e Shëndetësisë për Viktimat e Trafikimit dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit



Udhëzues për Zbatimin e Procedurave  
Standarde të Veprimit për Identifikimin  
dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit  
dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit



IOM • OIM

## PARATHËNIE

*Në korrik të vitit 2011, qeveria shqiptare miratoi një dokument të rëndësishëm të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore “Procedurat Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit (PSV)”.*

*Në mbështetje të zbatimit të detyrimeve që përmban ky instrument i rëndësishëm për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafik (ZKKAT), dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) me anë të konsulentës Znj. Valbona Lenja, në kuadrin e projektit të financuar nga USAID “Forcimi i Kapaciteteve Shqiptare Kundër Trafikimit”, ndërmorën botimin e një serie prej tetë broshurash, njëra prej të cilave është kjo që keni në dorë.*

*Secila prej broshurave synon të ndihmojë një grup të caktuar profesionistësh për të shfrytëzuar mundësitë që japin PSV-të dhe për të përdorur aftësitë dhe eksperiencën e tyre për të krijuar, të gjithë së bashku, një ambient në të cilin zbatohet ligji dhe respektohen të drejtat e viktimave të trafikimit.*

*Në përgatitjen e broshurave kontribuan specialistë të fushave të ndryshme e të domosdoshme për sistemin e identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit.*

*Në përgatitjen e kësaj broshure kontriboi Znj. Emanuela Tollozhina, Përgjegjëse e Sektorit të Shëndetit Mendor dhe Adiktologjisë, në Ministrinë e Shëndetësisë.*

Mbështetur nga projekti i financuar nga USAID  
“Fuqizimi i Kapaciteteve Shqiptare Kundër Trafikimit” i zbatuar nga IOM.

### SHËNIM

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA-ve apo të Qeverisë së SHBA-ve dhe/ose të Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (ONM).

## ÇFARË ËSHTË TRAFIKIM I PERSONAVE?

Trafikim i personave do të thotë “Rekrutim, transportim, transferim, fshehje ose pritje e personave nëpërmjet metodave të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo mendore ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin. Shfrytëzimi përfshin shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, vënien në përdorim ose transplantimim e organeve.”

Duke marrë në konsideratë përkufizimin e mësipërm, trafikimi i personave ka si elementë të tij kyç:

1. **Vepërtarinë** – rekrutimi, transporti, transferimi, mbajtja dhe pritja e personave;
2. **Mënyrat** – kërcënimi ose përdorimi i forcës ose i formave të tjera të rrëmbimit, mashtrimit, falsifikimit, abuzimit me pushtetin ose situatën e pafavorshme, ose nëpërmjet dhënies dhe marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontrollin mbi një person tjetër;
3. **Qëllimin** – shfrytëzimi i një personi sipas mënyrave të renditura në nenin 110/a të Kodit Penal apo Nenit 3 të Protokollit të Palermos.<sup>2</sup>

## Ç’DO TË THOTË VIKTIMË E TRAFIKIMIT ?

Sipas shkronjës “e” të nenit 4 të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër

1 Ligji Nr. 9188, datë 12.2.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi Penal i Shqipërisë’ i ndryshuar”, neni 110/a.

2 Manuali i IOM-it për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. IOM, 2007

trafikimit të qenieve njerëzore”, Viktimë e Trafikimit të qenieve njerëzore është personi objekt i trafikimit të qenieve njerëzore.

### VINI RE!

*Përcaktimi se një person është “viktimë e mundshme e trafikimit (VMT)” nuk do të thotë në asnjë mënyrë se personi nuk është trafikuar, ky përcaktim do të thotë vetëm që personi nuk është identifikuar “viktimë trafikimi (VT)” nga grupi/struktura përgjegjëse për identifikim formal në kufi dhe territor (G/SPIF).*

*Pavarësisht nga këto kategorizime, të gjithë personave qofshin të identifikuar si viktima të mundshme nga institucionet që bëjnë identifikimin fillestar, apo qofshin persona të identifikuar si viktima trafikimi nga struktura përgjegjëse për identifikim formal do t’u sigurohet akses i menjëhershëm tek ndihma e nevojshme.*

## PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË IDENTIFIKOHEN VIKTIMAT E TRAFIKIMIT?

Trafikimi i personave është shkelje ekstreme e të drejtave të njeriut. Si e tillë çdo dështim për të zbuluar krimin e ndodhur dhe për të identifikuar viktimat e trafikimit krijon mjedis për vazhdimësinë e krimit dhe krimeve të tjera dhe mohimin e aksesit të viktimave në drejtësi. Të gjithë aktorët antitrafik në Shqipëri e në botë i japin një rëndësi të veçantë identifikimit korrekt e sa më të shpejtë të viktimave të trafikimit për arsye se viktimat e trafikimit:

- kanë nevojë për asistencë dhe mbrojtje të specializuar;
- ka shumë të ngjarë të kenë probleme shëndetësore akute, si fizike dhe/ose mendore, që nuk i kanë migrantët e parregullt

- apo personat e kontrabanduar;
- kanë vuajtur nga krime të rënda e serioze dhe ka shumë mundësi që të jenë aktualisht në rrezik;
- kanë nevojë për veprime të veçanta të nevojshme për menaxhimin e rrezikut, qoftë për vetë ata/ato, qoftë për personelin e ndihmës të organizatave/institucioneve që i ndihmon.

### VINI RE!

**Vetëm identifikimi korrekt i jep mundësi viktimave të trafikimit të përfitojnë shërbimet e mëposhtme në përputhje me legjislacionin shqiptar**

- Viktimat e trafikimit të cilat janë në një program ndihme mund të marrin ndihmë juridike falas<sup>3</sup>.
- Viktimat e trafikimit mund të përfshihen në programin e mbrojtjes së dëshmitarit apo bashkëpunëtorëve të drejtësisë<sup>4</sup>.
- Viktimave të huaja të trafikimit u jepet leje pune për raste të veçanta e tipit “C” për qëllime biznesi, për t'u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional<sup>5</sup>.
- Viktimat e trafikimit përfshihen në përfituesit e ndihmës ekonomike pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre<sup>6</sup>.
- Viktimat e mundshme/viktimat e trafikimit mund të akomodohen në qendra rezidenciale të posaçme.

3 Ligji Nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, Neni 13: “Personat që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike”,

4 Ligji Nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, Neni 60.

5 Ligji Nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, Neni 60.

6 Ligji Nr. 10252, datë 11.03.2010, “Për disa shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, neni 1

## NDRYSHIMI MES TRAFIKIMIT DHE VEPRAVE PENALE TË LIDHURA ME TË

Problemet e hasura më dendur në identifikimin e viktimave të trafikimit, të cilat duhen shmangur, janë mos dallimi i trafikimit nga ushtrimi dhe/apo shfrytëzimi i prostitucionit, apo nga dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit (kontrabandim)<sup>7</sup>.

***Trafikimi është skllavërim. Trafikim konsiderohen të gjitha veprimet të cilat konsistojnë në mbajtjen dhe përdorimin e individit për shërbime të detyruara. Thelbi i trafikimit janë format e skllavërimit e jo elementët e rekrutimit, fshehjes, transportimit (pra elementët e lëvizjes).*** Të gjithë personat e përfshirë në rekrutimin, transportimin, fshehjen, pritjen, apo mbajtjen e personit në situatë skllavëruese janë të përfshirë në trafikim. Nëse një person është mbajtur në prostitucion me anë të manipulimit psikologjik, forcës fizike, mashtrimin...; **ai/ ajo është viktimë trafikimi. Kur një person detyrohet, dhunohet apo mashtrohet, apo mbahet forcërisht në prostitucion, ky person është viktimë trafikimi, edhe nëse personi fillimisht ka hyrë në prostitucion me vullnet të tij.**

Në tabelën më poshtë do të gjeni në mënyrë të përmbledhur elementët që bëjnë ndryshimin mes këtyre veprave penale.<sup>8</sup>

7 Përkatesisht ndryshimi mes neneve 110/a dhe 114/a, 298 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

8 ICMPD. Guidelines for the Development and Implementation of a Comprehensive National Antitrafficking Response. ICMPD, 2006.

Trafikimi i personave Nenet 110/114 b/128 b të KP	Dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit Neni 298 i KP
Krim i kryer ndaj personit	Krim i kryer ndaj shtetit
Kryhet, ndër të tjera, edhe nëpërmjet transportimit ndërkufitar.	Kryhet vetëm nëpërmjet transportimit ndërkufitar.
Shfrytëzim i vazhdueshëm i viktimës.	Sigurimi i një përfitimi në këmbim të sigurimit të hyrjes së paligjshme në një shtet tjetër.
Marrëdhënia shfrytëzuese vazhdon për të maksimizuar përfitimet.	Me hyrjen e emigrantit të paligjshëm në shtetin e dëshiruar, marrëdhënia midis kontrabandistit dhe personit të kontrabanduar përfundon.
Kryhet pa pëlqimin/miratimin e viktimës.	Kryhet me vullnetin e lirë të të kontrabanduarit.
Luftohet për të ruajtur të drejtat e njeriut.	Luftohet për të mbrojtur integritetin e kufijve shtetërorë.

Person Viktimë Trafikimi	Person që Ushtron Prostitucion
Personi (femër, mashkull, fëmijë apo i rritur) kryen, ndër të tjera, marrëdhënie seksuale me pagesë i shtyrë me forcë, i mbajtur me forcë, i shtrënguar ose mashtruar, jo me vullnet dhe zgjedhje. Shtytja e personit mund të përmbajë elementë fizik ose psikologjik.	Personi (femër dhe mashkull i rritur) kryen marrëdhënie seksuale me pagesë jo i shtyrë me forcë, jo i mbajtur me forcë, i shtrënguar ose mashtruar, por me vullnet dhe zgjedhje të plotë <sup>9</sup> .

<sup>9</sup> Në rastin e fëmijëve ky përcaktim nuk vlen. Një fëmijë që kryen marrëdhënie seksuale me pagesë është viktimë trafikimi.

## PARIME TË PËRGJITHSHME TË ETIKËS DHE SIGURISË NË MARRËDHËNIE ME VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

Sipas Parimeve dhe Udhëzimeve të Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore “Të drejtat e njeriut të personave të trafikuar duhet të jenë në qendër të të gjitha përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar trafikimin, për të mbrojtur, ndihmuar dhe kompensuar viktimat”.

Parimet e mëposhtme të etikës dhe sigurisë në marrëdhënie me viktimat e trafikimit të cilat janë të integruara në PSV janë:

### *Për vajzat dhe gratë e trafikuar*<sup>10</sup>:

**Të mos lëndosh:** ta trajtosh çdo femër dhe çdo situatë sikur potenciali për ta dëmtuar atë është i lartë, deri sa të ketë prova për të kundërtën.

Do të thotë gjithashtu të mos ndërmarrësh asnjë intervistë që do ta përkeqësonte situatën e saj për një afat të shkurtër apo të gjatë.

**Ta njohësh personin që do të intervistosh dhe të vlerësosh rreziqet ndaj saj:** përpara se të zhvillosh intervistën duhet të mësosh rreziqet e lidhura me trafikimin dhe me rastin e çdo femre.

**Të përgatitesh për të referuar, të mos bësh asnjë premtim që nuk do ta mbash:** të përgatitesh të japësh informacion në gjuhën e saj lidhur me shërbimet ligjore, shëndetësore, sociale dhe të sigurisë, dhe të ndihmosh me referimin nëse është e nevojshme.

**Të zgjedhësh dhe të përgatitësh siç duhet përkthyesit dhe**

<sup>10</sup> Burimi: Organizata Botërore e Shëndetësisë

**bashkëpunëtorët:** në përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve, përkthyesve e të tjerëve duhet të peshosh rreziqet dhe përfitimet që ka përfshirja e tyre dhe duhet të zhvillosh kritere/metoda të përshtatshme për përzgjedhjen dhe trajnimin e tyre.

**Të sigurosh anonimat dhe konfidencialitet:** të mbrosh identitetin dhe konfidencialitetin e personit të intervistuar gjatë gjithë procesit të intervistës nga momenti që është kontaktuar deri në kohën kur detajet e rastit të saj bëhen publike.

**Të marrësh leje të informuar:** të sigurosh që çdo e intervistuar kupton përmbajtjen dhe qëllimin e intervistës, për se do të përdoret informacioni, të drejtën e saj për të mos iu përgjigjur pyetjeve, të drejtën për ta ndërprerë intervistën në çdo kohë dhe të drejtën e saj për të vënë kufizime për mënyrën se si do të përdoret informacioni.

**Të dëgjosh dhe respektosh vlerësimin që çdo femër i bën situatës së saj dhe rreziqeve për të:** të pranosh dhe respektosh që çdo femër ka shqetësime të ndryshme, dhe mënyra se si i sheh ajo shqetësimet e saj mund të jetë e ndryshme nga si i vlerësojnë të tjerët ato.

**Të mos e ri-traumatizosh femrën:** të mos i bësh asaj pyetje që do t'i provokojnë përgjigje emocionale. Do të thotë gjithashtu të përgatitesh t'i përgjigjesh stresit të një femre duke i vënë në pah forcat e saj.

**Të përgatitesh për ndërhyrje emergjente:** nëse një femër të thotë se është në një rrezik imediat, të jesh i/e përgatitur të reagosh në mbrojtje të saj.

### **Për fëmijët e trafikuar**

Të drejtat e fëmijëve të parashikuara në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve përbëjnë parimet e të gjitha veprimeve me fëmijët e trafikuar. Më poshtë janë disa prej tyre që konsiderohen si kyçe:

**Të njohësh dhe të mbrosh interesin më të mirë të fëmijës:** në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarr këto qoftë nga institucionet shoqërore të kujdesit publik ose privat, apo gjykata, autoritete administrative ose trupa ligjvënëse, duhen mbajtur parasysh në mënyrë parësore interesin më të lartë të fëmijës<sup>11</sup>.

**Të mos e diskriminosh fëmijën:** duhet të respektohen dhe të garantohen të drejtat që parashtrihen në Konventë për çdo fëmijë pa asnjë lloj diskriminimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, pikëpamjet politike a të tjera, origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, veçoritë, paaftësitë, lindja, a status tjetër i fëmijës ose i prindit të vet apo i kujdestarit ligjor<sup>12</sup>.

**Të njohësh dhe të respektosh të drejtën që fëmija ka që t'i dëgjohet pikëpamja e tij/saj e që kjo e fundit t'i merret parasysh në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fëmijën:** çdo fëmijë që është i aftë të shprehë pikëpamjet e veta duhet të ketë të drejtën për t'i shprehur këto pikëpamje lirshëm në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fëmijën, dhe pikëpamjet e fëmijës duhet të kenë peshën e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e secilit fëmijë<sup>13</sup>.

**Të respektosh të drejtën e fëmijës për privatësi:** asnjë fëmijë nuk duhet të pësojë ndërhyrje arbitrare ose të paligjshme në privatësinë, familjen, shtëpinë ose korrespondencën e tij, dhe asnjë goditje e paligjshme nuk duhet bërë ndaj nderit dhe emrit të fëmijës<sup>14</sup>.

<sup>11</sup> Neni 3.1 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

<sup>12</sup> Neni 2 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

<sup>13</sup> Neni 12 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

<sup>14</sup> Neni 16 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.



## SI ËSHTË I NDËRTUAR SISTEMI I IDENTIFIKIMIT TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT NË SHQIPËRI?

Procedurat standarde të veprimit e ndajnë identifikimin në kufijtë dhe territorin e RSH-së në dy momente kryesore: në identifikim fillestar dhe atë formal. Strukturat që bëjnë identifikimin fillestar janë të ndryshme. Qëllimi dhe strukturat jepen në tabelën më poshtë:

### Identifikimi Fillestar

Përcaktimi i identifikimit fillestar në kufi dhe territor	Strukturat Përgjegjëse për identifikim fillestar	
	Në territor	Në kufi
Identifikim fillestar i viktimave të trafikimit është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore në kufijtë dhe brenda territorit të RSH-së që bën të mundur përcaktimin se një person i mitur apo i rritur është viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore. Këto veprime duhet të përfshijnë minimalisht: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësimin e situatës së personave kundrejt treguesve të trafikimit</li> <li>2. Mbledhjen dhe analizën e informacionit fillestar mbi procesin e trafikimit të personit</li> <li>3. Informimin e personit për të drejtat dhe ndihmën në dispozicion të viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të trafikimit dhe mënyrat e qasjes tek ndihma,</li> <li>4. Dhënie e ndihmës së parë për ta nxjerrë personin nga rrjeti i shfrytëzimit dhe për rehabilitimin e tij/saj sa më të shpejtë në një mjedis të sigurt,</li> <li>5. Njoftimin e Grupit/Strukturës Përgjegjëse për Identifikim Formal (G/SPIF) dhe</li> <li>6. Bashkëpunimin dhe koordinimin për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të trafikuar.</li> </ol>	Strukturat e policisë së shtetit.	<b>POLICIA E KUFIRIT DHE MIGRACIONIT</b>
	Qendrat e përkujdesjes shoqërore për persona në nevojë.	
	Strehëzat për viktimat e trafikimit.	
	Organizatat me programe të ndihmës për persona në nevojë.	
	Zyrat e shërbimit social në rajone.	
	Inspektorati Shtetëror i Punës.	
Drejtoritë rajonale të arsimit, dhe zyrat rajonale arsimore.		
Drejtoritë Rajonale të Shëndetësisë/Drejtoria e Shëndetit Publik.		
Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki e Komuna.		

## IDENTIFIKIMI FORMAL

Identifikimi formal i viktimave të trafikimit në kufijtë dhe territorin e RSH-së është identifikimi i një personi si viktimë trafiki i kryer vetëm nga Grupi/Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal (G/SPIF) në bazë të formatit të intervistës formale të përfshirë në dokumentin e PSV-ve.

Identifikimi formal duhet të arrijë minimalisht:

1. Përcaktimin nëse personi është viktimë e trafikimit, nëpërmjet mbledhjes dhe analizës së informacionit të dhënë nga vetë personi,
2. Vlerësimin në mënyrë të thelluar të nevojave të personit viktimë e trafikimit për ndihmë dhe mbrojtje,
3. Dhënie e udhëzimeve dhe sigurimin e qasjes së personit të trafikuar tek ndihma e përshtatshme dhe e sigurt,
4. Grumbullimin e informacionit dhe nisjen e hetimeve për penalizimin e trafikantëve.

Intervista formale dhe të gjitha veprimet për përcaktimin e statusit të personit në lidhje me trafikimin, kryhen në kohën më të shpejtë të mundshme pas identifikimit të personit si viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore.

Intervista formale kryhet veçmas në kohë nga kallëzimi. Edhe nëse personi dëshiron të bëjë kallëzim, në asnjë rast, intervista formale nuk ndërpritet për të marrë kallëzimin, por caktohet një kohë tjetër. Intervista formale kryhet në çdo rast në ambientet e intervistimit të policisë së SLKTP, dhe të gjitha organizimat e nevojshme për kryerjen e intervistës formale, përfshirë njoftimin e punonjësit social shtetëror, janë përgjegjësi e punonjësit të policisë së SLKTP.

## PARIME UDHËHEQËSE SPECIFIKE PËR PUNONJËSIT E SHËNDETËSISË

1. Respekto parimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë<sup>15</sup>;
2. Trajto çdo kontakt me personat e trafikuar si një hap drejt përmirësimit të shëndetit të tyre;
3. Jepi prioritet sigurisë së personave të trafikuar, vetes dhe stafit;
4. Ofro kujdes me respekt, barazi dhe pa diskriminim;
5. Përgatit informacion referimi dhe detaje kontakti të njerëzve të besuar;
6. Bashkëpuno me ofruesit e tjerë të shërbimit;
7. Siguro konfidencialitet dhe privatësi për personat e trafikuar dhe familjet e tyre;
8. Jep informacion në një gjuhë që personi e kupton;
9. Merr leje të informuar dhe me vullnet të plotë;
10. Respekto të drejtat, zgjedhjet dhe dinjitetin e çdo individ;
11. Mënjano thirrjen e autoriteteve si policia apo shërbimet e migracionit pa lejen e personit të trafikuar;
12. Mbaje informacionin mbi personat e trafikuar në një vend të sigurt.

## DETYRAT SPECIFIKE TË PUNONJËSVE TË SHËNDETËSISË

PSV-të përmbajnë detyra specifike për punonjësit e shëndetësisë, për identifikimin, referimin dhe ndihmën rehabilituese e integruese apo riintegruese për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, qofshin këta të mitur apo të rritur, shtetas shqiptarë apo të huaj.

Më poshtë jepet një tabelë orientuese për detyrimet kryesore të punonjësve të shëndetit:

<sup>15</sup> Parimet e dhëna në fillim të broshurës



*Rol Primar*



*Rol monitorues*



*Rol mbështetës*

Strukturat ku operojnë		Detyrimet e Punonjësve të Shëndetësisë		
		Identifikim dhe ndihmë fillestare		Ndihmë për rehabilitim dhe rintegrim
		Fillestar	Formal	
Drejtoria e Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë	Spektori i Shëndetit Riprodhues			
	Spektori i Higjenës dhe Epidemiologjisë			
	Spektori i Shërbimeve të Mjekësisë Familjare & Shërbimit Dentar			
	Spektori i Shëndetit Mendor & Adiktologjisë			



Strukturat ku operojnë		Detyrimet e Punonjësve të Shëndetësisë			
		Identifikim dhe ndihmë fillestare		Ndihmë për rehabilitim dhe rintegrim	
		Fillestar	Formal		
Drejtoritë Rajonale të Shëndetësisë / Drejtoria e Shëndetit Publik	Pika/grupi fokal për çështjet e antitrafikimit				
	QSH	Kujdesi në rastet e urgjencës.			
		Kujdesi shëndetësor për fëmijët.			
		Kujdesi shëndetësor për të rriturit.			
		Kujdesi shëndetësor për gratë dhe shëndeti riprodhues.			
		Kujdesi shëndetësor për të moshuarit.			
		Promocioni dhe edukimi shëndetësor.			
		Kujdesi shëndetësor mendor.			

## VEPRIMET E PUNONJËSVE TË SHËNDETËSISË

Për të bërë një identifikim, referim dhe ndihmë fillestare korrekte, punonjësit e shëndetësisë duhet:

*Të përdorin treguesit e vënë në dispozicion në dokumentin e PSV-ve:*

PSV-të kërkojnë që identifikimi fillestar në territor (pra edhe nga punonjësit e shëndetësisë) të bëhet nëpërmjet (metoda) intervistave për qëllime të ndihmës, observim, vlerësim i informacionit nga individë të veçantë apo agjenci të tjera shtetërore dhe jo-shtetërore kundrejt treguesve të trafikimit.

Tregues për të miturit - Parësorë	Tregues për të rriturit - Parësorë
<ul style="list-style-type: none"> <li>· I mituri/ e mitura deklaron se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar dhe është i kënaqur/ e kënaqur që ka rënë në kontakt me persona/ autoritete që japin ndihmë dhe jep shenja se kërkon ndihmë;</li> <li>· I mituri/ e mitura ka shenja në trup, (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;</li> <li>· I mituri që lyp ka gjithmonë një të rritur pranë që e kontrollon;</li> <li>· I mituri/ e mitura shet ose punon;</li> <li>· I mituri/ e mitura nuk ka kontakte me familjen dhe nuk ka person me lidhje gjaku që kujdeset për të;</li> <li>· I mituri/ e mitura është sjellë në vendin e konstatimit/ qytetin apo krahinën nga një person i rritur apo më i rritur me të cilin nuk ka lidhje familjare;</li> <li>· I mituri/ e mitura i paregjistruar, qëndron me persona të rritur me të cilët nuk ka lidhje familjare;</li> <li>· I mituri/ e mitura nuk ka një vendbanim të qëndrueshëm;</li> <li>· I mituri/ e mitura fle në rrugë;</li> <li>· I mituri/e mitura është në shoqërinë e personave që shfrytëzojnë apo trafikojnë të miturit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>· Personi deklaron se është shfrytëzuar dhe kërkon ndihmë.</li> <li>· Personi ka ardhur në një situatë shfrytëzimi nëpërmjet rrëmbimit apo nëpërmjet një premtimi që ka rezultuar i rremë.</li> <li>· Personi është i detyruar të qëndrojë në një situatë shfrytëzimi për shkak të kërcënimeve dhe dhunës ndaj tij/saj ose personave të afërt me të.</li> <li>· Personi nuk ka kontroll mbi jetën e tij: lëvizja, strehimi, përdorimi i të ardhurave, udhëhiqen dhe kontrollohen nga persona të tjerë.</li> <li>· Transporti i personit, strehimi, punësimi, janë rregulluar nga persona që njihen apo për të cilët ka informacion se janë trafikantë apo shfrytëzues.</li> </ul>

Tregues për të miturit - Dytësorë	Tregues për të rriturit - Dytësorë
<ul style="list-style-type: none"> <li>· I mituri/ e mitura frekuenton vende të njohura për aktivitete të paligjshme; (shpërndarje droge, ushtrim prostitucioni, shkëmbim mallrash të vjedhura,etj);</li> <li>· I mituri/ e mitura është kapur duke vjedhur;</li> <li>· I mituri/ e mitura që lyp duket i/e lënë pas dore: është i/e keq- ushqyer; veshur në mënyrë të papërshtatshme për moshën apo kushtet atmosferike;</li> <li>· E mitura ka shtatzëni të padëshiruar;</li> <li>· I mituri/ e mitura vuan nga sëmundje seksualisht të transmetueshme;</li> <li>· Ka të dhëna apo informacion që i mituri/ e mitura është parë në vende që njihen se përdoren për shfrytëzim seksual të fëmijëve, për lypje, punë të detyruar, apo vende të tjera të papërshtatshme për moshën;</li> <li>· I mituri/ e mitura ka lënë shtëpinë / vendin e kujdesit me rroba që janë të pazakonshme për këtë të mitur (të papërshtatshme për moshën, i ka marre borxh prej më të rriturve);</li> <li>· Ka të dhëna që i mituri/ e mitura merr telefonata apo letra nga të rritur jashtë rrethit të zakonshëm apo kontakteve të zakonshme shoqërore;</li> <li>· Ka të dhëna që rreth rezidencës apo vendbanimit të të miturit/ te miturës sillen rrotull të rritur me sjellje dhe veprimtari të dyshimtë;</li> <li>· I mituri/ e mitura qëndron jashtë banesës, i/e vetëm në orët e vona të natës;</li> <li>· I mituri/ e mitura ka të dashur shumë më të madh/e në moshë;</li> <li>· I mituri/ e mitura ka shuma të mëdha parash të pajustificueshme;</li> <li>· I mituri/ e mitura ka munguar/ është larguar për një kohë të gjatë por nuk ka asnjë informacion mbi atë që ka ndodhur;</li> <li>· I mituri/ e mitura në situatë rruge ka shenja të dukshme neglizhimi dhe braktisjeje;</li> <li>· I mituri /e mitura është kthyer pas një mungese, me një pamje të ndryshuar por që nuk ka ndodhur nga kujdestari ligjor apo nga prindërit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>· Kushtet në të cilat ka punuar/ punon personi, kanë qenë të dëmshme për shëndetin dhe jetën e personit;</li> <li>· Personit ia ka rregulluar punën, shkollën një person i cili/ e cila ka marrëdhënie biznesi me punëdhënësin/ punëdhënësen;</li> <li>· Personit nuk i është lejuar të zgjedhë strehimin;</li> <li>· Personi paguan tek punëdhënësi një shumë të madhe e të pajustificueshme për strehimin e tij/ saj;</li> <li>· Personi fshihet nga autoritetet për shkak të statusit të parregullt të punës së tij/saj;</li> <li>· Personi nuk ka akses në kujdesin shëndetësor;</li> <li>· Personi ka/ ka patur kontakte sociale të kufizuara;</li> <li>· Personi nuk ka/ nuk ka patur kontroll mbi privatësinë dhe pronën e vet;</li> <li>· Personi nuk ka patur akses në informacionin shëndetësor apo në kujdesin shëndetësor;</li> <li>· Personit nuk i respektohej e drejta e tij/saj për kohë të lirë, pushime të paguara etj;</li> <li>· Kushtet e banimit të personit nuk plotësonin nevojat e tij/saj bazë higjieno- sanitare.</li> <li>· Personi nuk di gjuhën, dhe nuk orientohet dot në vendin ku është.</li> </ul>

## VINI RE!

*Në PSV tërhiqet vëmendja që të gjitha institucionet shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit duhet të mos i konsiderojnë këta tregues si një listë shteruese e paraqitjes së trafikimit dhe pasojave të tij, por të përdorin gjykimin e tyre profesional dhe të rifreskojnë në mënyrë të vazhdueshme njohuritë e tyre mbi çdo prirje të paraqitjes së trafikimit dhe efekteve të tij mbi personat në komunitetet ku punojnë.*

*Të njohin dëmtimet shëndetësore nga trafikimi, sidomos ato fizike, seksuale dhe mendore.*

Siç mund të kuptohet lehtë, treguesit e PSV-ve janë hartuar për një gamë të gjerë institucionesh, përfshirë punonjësit e shëndetësisë. Në përdorimin e treguesve më lart, punonjësit e shëndetësisë duhet të mbajnë parasysh se pjesa më e madhe e personave të trafikuar u ekspozohen rreziqeve të shëndetit përpara, gjatë ose pas shfrytëzimit. Tabela e mëposhtme jep përmbledhtas disa prej rreziqeve dhe pasojave shëndetësore të trafikimit. Shumë prej rreziqeve dhe pasojave, mbivendosen, sidomos komorbiditeti psikologjik, i cili është i lidhur me pjesën më të madhe të rreziqeve shëndetësore fizike, seksuale dhe shoqërore.

Rreziqet	Pasojat e mundshme shëndetësore
Abuzimi fizik, deprivimet	Probleme shëndetësore fizike që përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• vdekjen;</li> <li>• ndrydhjen;</li> <li>• prerjet;</li> <li>• fraktura;</li> <li>• hematoma</li> <li>• cicatrice</li> </ul>

Rreziqet	Pasojat e mundshme shëndetësore
<b>Kërcënimet, frikësimet, abuzimet</b>	<p>Probleme mendore që përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mendime për të vrarë veten dhe tentativa për ta bërë këtë;</li> <li>• depresion;</li> <li>• çrregullime të ankthit;</li> <li>• armiqësi;</li> <li>• përfytyrime dhe ri-përjetime mendore të eksperiencave.</li> </ul>
<b>Abuzimi seksual</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Infeksione seksualisht të transmetueshme, (përfshirë HIV/AIDS).</li> <li>• sëmundje inflamatorë të pelvisit, infertilitet.</li> <li>• fistula vaginale;</li> <li>• shtatzëni e padëshiruar;</li> <li>• aborte të pasigurta;</li> <li>• çrregullime të shëndetit riprodhues.</li> </ul>
<b>Abuzimi me substancat (droga, alkool, duhan, etj...)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• mbidoza;</li> <li>• varësia ndaj substancave.</li> </ul>
<b>Kufizimet sociale, manipulimet &amp; abuzimi emocional</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• çrregullime psikologjike;</li> <li>• pamundësi për të marrë shërbime.</li> </ul>
<b>Shfrytëzimi ekonomik</b> Futje në borxh, “pazare” mashtruese.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• ushqim apo lëngje të pamjaftueshme,</li> <li>• ndërmarrja e rreziqeve shëndetësore për të larë borxhet,</li> <li>• fonde të pamjaftueshme për të paguar për kujdesin shëndetësor.</li> </ul>
<b>Pasiguria ligjore</b> Aktivitete të paligjshme të detyruara, konfiskim i dokumenteve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• kufizim ose hezitim për t’iu qasur shërbimeve, që sjell si pasojë përkeqësim të shëndetit.</li> </ul>
<b>Rreziqe të vendit të punës</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushte të rrezikshme pune,</li> <li>• Trajnim ose pajisje të këqija, ekspozim ndaj kimikateve,</li> <li>• Rreziqeve bakteriale apo fizike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• dehidratim,</li> <li>• plagë fizike,</li> <li>• infeksione bakteriale,</li> <li>• mbi-ekspozim ndaj të ftohtit apo të nxehtit.</li> </ul>

***Të reagojnë me ndjeshmëri ndaj qëndrimeve të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit ndaj identifikimit dhe ofrimit të ndihmës***

Njohuritë dhe informacioni i deritanishëm tregojnë se simptomat dhe problemet më të hasura tek gratë e vajzat e trafikuarra janë:

- dhimbje koke,
- lodhje,
- marrje mendsh,
- humbje e kujtesës,
- infeksione seksualisht të transmetueshme,
- dhimbje barku,
- dhimbje shpine,
- probleme dentare,
- rënia në peshë,
- çrregullime të të ngrënit,
- çrregullime të gjumit.

Ju duhet të jeni të vetëdijshëm se fëmijët viktimë/viktima të mundshme të trafikimit, shumë rrallë do të donin të identifikoheshin si të tillë sepse:

- Mendojnë se janë duke ndihmuar familjen e tyre dhe nuk po shfrytëzohen;
- Kanë frikë se mos u dënohen prindërit;
- Nuk dinë ç’do të thotë trafikim dhe që eksperiencia e tyre ka qenë trafikim dhe nuk e dinë që kanë të drejtë për ndihmë;
- Kanë frikën e hakmarrjes ndaj tyre dhe vëllezërve, motrave dhe prindërve të tyre;
- Kanë frikë se mos duke u identifikuar, situata e tyre do të përkeqësohet.

Ju duhet të jeni të vetëdijshëm që në disa raste, ofertat për ndihmë mund të mos mirëprehen nga fëmijët viktimë të trafikimit. Në shumë raste ata nuk kanë patur eksperiencia të dhënies së ndihmës pa kushte dhe për këtë arsye mund të mos besojnë as tek ju. Fëmija mund të mos

jetë në gjendje psikologjike të kuptojë dhe të pranojë ndihmën.

***Të ndjekin hapat dhe të dokumentojnë e shkëmbejnë informacion në përputhje me PSV-të:***

Më poshtë është një ekstrakt i përshtatur i PSV-ve për hapat specifike për identifikimin fillestar të personave viktimë të mundshme të trafikimit në territorin e RSH-së:

**1:** Punonjësi i agjencisë/institucionit përgjegjës të drejtpërdrejtë për identifikimin fillestar në territor (A/IPIF) vlerëson se **personi** është viktimë e mundshme e trafikimit (VMT) duke përdorur listën e treguesve

***Specifikim i këtij hapi për punonjësit e shëndetësisë:***

Për të vlerësuar se një person është viktimë e mundshme trafikimi, përveç evidentimit të simptomave në mënyrë standarde, punonjësit e shëndetësisë mund të bëjnë disa pyetje anamneze si në seksionet e tabelës më poshtë dhe ta analizojnë gjithë informacionin e mbledhur përkundrejt treguesve<sup>16</sup>;

Nr.	Anamneza për:	Pyetjet që mund të drejtohen
1	<b>Koka/sytë/veshë /hunda/fyti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• A është goditur ndonjëherë në kokë (Ekzamino kokën për mavijosje, shtypje apo laceracione të shëruara) ?</li> <li>• A është ekspozuar ndaj zhurmave të forta?</li> <li>• A ka patur dhimbje koke të shpeshta?</li> <li>• A ka patur traumë faringeale (laceracione, ulcera)?</li> <li>• Dhimbje dhëmbësh apo te gengivave?</li> <li>• Ndryshime të pamjes (të papritura apo graduale)?</li> </ul>

<sup>16</sup> Shih treguesit më lart

Nr.	Anamneza për:	Pyetjet që mund të drejtohen
2	<b>Genitourinare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Seks i detyruar, apo traumë seksuale që përfshin objekte të huaja?</li> <li>• Enuresis ose encopresis (një pasojë e mundshme e abuzimit seksual)?</li> </ul>
3	<b>Muskuloskeletike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Plagë të përsëritura apo të papërsëritura të lidhura me punën?</li> <li>• Fraktura?</li> <li>• Histori e abuzimit fizik si djegie?</li> <li>• Kontraksione?</li> <li>• Mungese e vitaminës D?</li> </ul>
4	<b>Respiratore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• A është ekspozuar kundrejt kimikateve, tymrave, azbesteve, apo gjëra të tjera të këtij lloji në punë?</li> <li>• A është ekspozuar ndaj TB (kushtet e punës, numri i njerëzve që ndajnë dhomën e gjumit me të, ajrosja, etj)?</li> </ul>
5	<b>Gastrointestinale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Traumë abdominale?</li> <li>• Diarre kronike, konstipacion, parazitë të dukshëm në jashtëqitje?</li> </ul>
6	<b>Neurologjike/të sjelljes</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kriza epileptike (duhet të konsiderohen edhe pseudo kriza të tilla)?</li> <li>• Çrregullime të gjumit si në cilësi dhe në sasi (pamundësi për ta zënë gjumi, zgjime të shpeshta, makthe)?</li> <li>• Histori të goditjes në kokë?</li> </ul>
7	<b>Qafa</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shenja të mbytjes/strangulimit ?</li> </ul>
8	<b>Kardiovaskulare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trauma të kraharorit/gjoksit?</li> </ul>
9	<b>Ushqyerja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nën/Kequshqyerje (sasi dhe përmbajtje)?</li> <li>• Çrregullime të të ngrënit (anoreksi apo bulimi)?</li> </ul>
10	<b>Dermatologjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjebe?</li> <li>• Morra (parazitë të ndryshëm)?</li> <li>• Pak flokë ose flok i hollë?(gjë që mund të tregojë edhe mungesë ushqimi)</li> <li>• Djegie (p.sh. prej cigares, ujit të nxehtë),</li> <li>• Puçrra dhe infeksione fungale?</li> </ul>

2. Punonjësi i A/IPIF bën një vlerësim të nevojave të personit viktimë e mundshme trafikimi dhe këshillohet me eprorin e tij/saj për të marrë masa të menjëhershme që në gjykimin e tyre janë të nevojshme dhe të mundshme për ndalimin e shfrytëzimit dhe rehabilitimin e sigurt të tij/saj;

*PSV-të kërkojnë që nëse punonjësi dhe eprori i tij/saj gjykojnë se nuk kanë mundësi të bëjnë një vlerësim të përshtatshëm dhe të ndërhyjnë në mënyrë të menjëhershme dhe të sigurt për ndalimin e trafikimit të personit viktimë e mundshme trafikimi dhe rehabilitimin e tij/saj, agjencia/institucioni (A/IPIF) njofton në mënyrë të menjëhershme punonjësin e policisë të SLKTP më të afërt, dhe i kërkojnë të ndërhyjë për verifikimin e situatës së personit viktimë e mundshme trafikimi dhe marrjen e masave mbrojtëse.*

#### **Specifikim i hapit dhe kësaj kërkesë për punonjësit e shëndetësisë:**

Punonjësi i shëndetësisë njofton drejtuesin e shërbimit dhe nëse ata gjykojnë se asnjë zgjidhje apo ndihmë që mund t'i jepet nga shërbimi shëndetësor, nuk e shpëton personin viktimë e mundshme trafikimi nga trafikimi, së bashku informojnë personin e rritur apo të mitur për gjykimin e tyre, për situatën e tij/saj dhe detyrimin që ka për të raportuar për dhunën, shfrytëzimin dhe/ose trafikimin.

#### **Në rast se personi dëshiron të largohet dhe të mos kontaktojë me policinë (SLKTP) :**

Personit, viktimë e mundshme trafikimi, i jepet informacion se ku duhet të drejtohet për ndihmë në rast se ai/ajo dëshiron të largohet. Pas kësaj, drejtori i shërbimit dhe personeli shëndetësor që ka rënë në kontakt me personin viktimë e mundshme trafikimi, njoftojnë menjëherë verbalisht Sektorin e Luftës Kundër Trafikeve të Paligjshme (SLKTP) në Drejtorinë e Policisë së Qarkut për ndërhyrje të menjëhershme. Njoftimi verbal duhet të përmbajë të gjithë

informacionin e nevojshëm për ta ndihmuar policinë të ndërhyjë.

Pas njoftimit verbal të SLKTP, njoftohet po verbalisht dhe Drejtoria Rajonale Shëndetësore/Drejtoria e Shëndetit Publik, për situatën dhe veprimet e kryera.

Menjëherë pas njoftimit verbal (brenda dy ditëve), drejtuesi i shërbimit dhe personeli shëndetësor që ka bërë këtë njoftim, përgatisin njoftimin me shkrim të SLKTP, ( identik me informacionin verbal, formati i kërkesës për ndërhyrje të menjëhershme të SLKPT jepet në aneksin 9.13 të PSV-ve) dhe e dërgojnë atë si vijon:

- a. Origjinalin tek SLKTP (të mbyllur në zarf ku shkruhet **urgjente dhe konfidenciale**)
- b. Një kopje tek Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë/Drejtoria e Shëndetit Publik (kopja mbyllet në zarf ku shkruhet **urgjente dhe konfidenciale**).
- c. Një kopje mbahet në Qendrën Shëndetësore (të merren masa për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/dokumentit)

#### **Specifikim i këtij hapi e kërkesë për Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë/Drejtorinë e Shëndetit Publik :**

Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë/Drejtoria e Shëndetit Publik e përcjell kopjen e njoftimit me shkresë përcjellëse tek:


- a. Autoriteti Përgjegjës (të mbyllur në zarf ku shkruhet **urgjente dhe konfidenciale**)
- b. Drejtorisë së Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë (të mbyllur në zarf ku shkruhet **urgjente dhe konfidenciale**).
- c. Një kopje mbahet në Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë/Drejtorinë e Shëndetit Publik (të merren masa për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/dokumentit)

**Në rast se personi dëshiron të kontaktojë me policinë (SLKTP) dhe të intervistohet menjëherë:**

Njoftohet SLKTP për ta shoqëruar personin në ambiente të përshtatshme për intervistë formale, jepet informacion mbi ndërhyrjet, ndihmën e dhënë dhe ofrohet gadishmëri për mbështetjen e intervistës formale.

Edhe në këtë rast ndiqen hapat e njoftimit/kërkesës zyrtare të SLKTP, njoftimit verbal dhe zyrtar të Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë/ Drejtorisë të Shëndetit Publik, dhe njoftimin e Autoritetit Përgjegjës dhe Ministrisë së Shëndetësisë nga ana e vetë Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë/Drejtorisë të Shëndetit Publik.

**Skema e Identifikimit Fillestar të Viktimave të Mundshme të Trafikimit në territorin e Republikës së Shqipërisë**



**ANEKS**

**TABELË E MONITORIMIT TË SUKSESIT TË PROCESIT SIPAS PËRGJEGJËSIVE TË PUNONJËSVE TË SHËNDETËSISË**

Struktura	Roli në identifikim	Treguesit e Suksesit	Institucioni/ struktura monitoruese
Drejtoria Rajonale Shëndetësore/ Drejtoria e Shëndetit Publik	Monitorues i identifikimit fillestar	- Numri i personave të identifikuar dhe referuar si viktima të mundshme të trafikimit	<b>DREJTORIA E SHËNDETIT PUBLIK (MINISTRIA E SHËNDETËSISË)</b>
Qendra Shëndetësore	Institucion i identifikimit fillestar	- Numri i personave të identifikuar dhe referuar si viktima të mundshme të trafikimit	<b>DREJTORIA RAJONALE SHËNDETËSORE /DREJTORIA E SHËNDETIT PUBLIK</b>



## Kërkesë për ndërhyrje të menjëhershme Aneks 9.13

### KËRKESË PËR NDËRHRYRJE TË MENJËHERSHME TË SLKTP

Data:

Subjekti i kërkesës:

1. Emri i dhe përshkrimi i punës së agjencisë / institucionit që bën kërkesën:
2. Përshkrim i rrethanave në të cilat agjencia ka rënë në kontakt apo ka marrë kontakt me viktimën e mundshme të trafikimit:
3. Të dhënat në dispozicion të agjencisë për personin që gjykohet si viktimë e mundshme:

Emri Mbiemri:

Mosha:

Vendbanimi:

Vendndodhja:

Nëse i/e mitur emrat e prindërve:

Nëse i/e mitur emri i kujdestarit nëse nuk është prindi:

4. Përshkrim i rrethanave që kanë bërë agjencinë të mendojë se personi është viktimë e mundshme e trafikimit:
5. Përshkrim i përpjekjeve që ka bërë agjencia/ institucioni për ta shpëtuar apo për ta ndihmuar viktimën e mundshme:
6. Rekomandimet që jep agjencia/ institucioni për ndërhyrjen e policisë SLKTP:
7. Emri, mbiemri dhe kontaktet e personit të agjencisë/ institucionit, që mund të kontaktohet nga punonjësit e policisë së SLKTP për informacione të mëtejshme:



